



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I TIRANËS  
SENATI AKADEMIK

Nr. 1077/prot.  
3

Tiranë, më 26.11.2021

VENDIM

Nr. 35, datë 25.11.2021

**“Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm (PBA) 2022- 2024, për Universitetin e Tiranës”**

Bazuar në Ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 3, pika 3, germa “c”, neni 38, pika 1, germa “h”, neni 108; Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; Ligji nr. 137, datë 26.11.2020, “Për buxhetin e vitit 2021”, i ndryshuar; Ligjin nr. 10 296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar; Statutin e Universitetit të Tiranës, neni 7, pika 3, germa c), neni 31, germa “o”, neni 143; Udhëzimin nr.7, datë 20.02.2018, të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit Buxhetor afatmesëm”, Senati Akademik i Universitetit të Tiranës, në mbledhjen e datës 25.11.2021, mori në shqyrtim dhe diskutoi programin buxhetor afatmesëm (PBA) 2022-2024, për Universitetin e Tiranës, nga Administratori i UT-së.

Senati Akademik duke konstatuar se, në këtë material janë marrë në konsideratë kërkesat e njëjve shpenzuese,

**VENDOSI:**

1. Miratimin paraprak të programit buxhetor afatmesëm (PBA) 2022- 2024, për Universitetin e Tiranës.
2. Vendimi t’i përcillet Bordit të Administrimit të UT-së për miratim përfundimtar.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR**  
**Prof. Dr. Artan Hoxha**